

**FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS  
KOSOVA KARATE FEDERATION**



**RREGULLORE PËR REGJISTRIM**

Prishtinë 2021

## **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

1. Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për regjistrim të klubeve si dhe garuesve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe zyrtarë tjerë, mënyrën e kalimit të garuesve nga klubi në klub dhe e drejta e tyre për pjesëmarrje në garat e Federatës së Karatesë të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm FKK-së), dëmet dhe kompenzimet për garues, kontratat në mes garuesve dhe klubeve, transferimin e garuesve, pjesëmarrja e shtetasve të huaj për klube anëtarë të FKK-së, pjesëmarrja e shtetasve Kosovar të cilët jetojnë jashtë teritorit të Republikës së Kosovës për klubet në Kosovë në garat zyrtare të FKK-së, pjesëmarrja e shtetasve të Kosovës jashtë vendit, si dhe regjistrat dhe mënyra e udhëheqjes së tyre.
2. Autoriteti kompetent për zbatim të kësaj rregulloreje është Zyra Administrative e FKK-së.
3. Klubet, garues, trajnerët, gjyqtarët dhe zyrtarët tjerë duhet të regjistrohen përmes Zyrës Administrative të FKK-së.
4. Bordit Ekzekutiv i FKK-së është organ mbikëqyrës i zbatimit të kësaj rregulloreje nga Zyra Administrative e FKK-së.

### **Neni 2**

1. Me këtë rregullore përcaktohen marrëdhëniet kontraktuese në mes klubeve dhe garuesve, afatet kalimtare, kalimi i garuesve nga klubi në klub, çështja e dëmshpërblimit dhe çështja e transferimit të garuesve.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të obligueshme për të gjitha klubet, për garues dhe persona të tjerë anëtarë të FKK-së.

#### **a) Të drejtat dhe detyrimet për garues**

### **Neni 3**

1. Këto të drejta dhe detyrime nga kjo rregullore bazohen në parimet e mëposhtme:
  - a) garuesi zgjedh klubin për të cilin dëshiron të garoj;
  - b) për regjistrimin e parë të garuesit, për kalimin e garuesit të mitur nga klubi në klub dhe për nënshkrimin e kontratës së garuesit të mitur kërkohet nënshkrimi i njërit nga prindërit, përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit;
  - c) garuesi i cili i ka mbushur tetëmbdhjet (18) vjet vendosë për nënshkrimin e kontratave sportive;
  - d) të drejtat dhe detyrimet e garuesit amator me klubin bazohen në rregullat e përgjithshme të klubit që rregullojnë çështjet e kompenzimit për ushqim, bursë, shpërblime për arritjet sportive, kompenzimi për udhëtim etj.

#### **Neni 4**

1. Anëtare të FKK-së janë klubet e karatesë të regjistruara në regjistrin e shoqatave të Republikës së Kosovës, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
2. Anëtar i rregullt i FKK-së konsiderohet klubi i karatesë i cili i ka përmbushë të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me statut të FKK-së dhe Rregulloren për Regjistrim.
3. Një klub konsiderohet zyrtarisht i regjistruar vetëm pas miratimit të anëtarëve të Kuvendit të FKK-së.

#### **Neni 5**

1. Garues konsiderohet personi që merrë pjesë në gara sportive si anëtar i klubit sportiv të karatesë.
2. Garuesi duhet të regjistrohet si garues – ME ose PA kontratë ndërmjet tij/saj.

#### **Neni 6**

1. Në zyrën administrative të FKK-së administrohen dhe mbahen librat amë të regjistrimit të anëtarëve të FKK-së.
2. Në librat amë të regjistrimit administrohet dhe mbahet evidenca e klubeve të karatesë, garueseve, gjyqtarët, trajnerët dhe zyrtarë tjerë të FKK-së.
3. Regjistrat e krijuar me këtë Rregullore janë të dhëna publike që administrohen dhe mbahen nga Zyra Administrative e FKK-së dhe/ose kryesueset e komisioneve përkatëse me mbikëqyrje të Sekretarit.
4. Bordi Ekzekutiv duhet të sigurojë Libra Amë dhe të atëtozojë Administratën e FKK-së për:
  - a) klubet e FKK-së
  - b) garues
  - c) trajner
  - d) gjyqtarë
5. Regjistrat administrohen në parimet e detyrueshme (falsifikimi, ndërhyrje të paautorizuara në të dhëna, manipulimi i të dhënave, dëmtimet fizike), publike dhe si të vërteta.
6. Regjistrat mbahen në kopje fizike dhe në kopje elektronike në FKK.

#### **Neni 7**

1. Çdo garues i regjistruar ka librezën për regjistrim të vërtetuar nga FKK-ja

2. Libreza për regjistrim përmbanë:

- a) *Fotografinë e garuesit;*
- b) *Emrin e mbiemrin e garuesit;*
- c) *Datën dhe vendin e lindjes të garuesit;*
- d) *Numrin amë të garuesit;*
- e) *Numrin e regjistrimit vjetor të garuesit;*
- f) *Emrin e klubit për të cilin garuesi është i regjistruar;*
- g) *Kontrollimin mjekësor jo më të vjetër se 12 muaj.*

3. Libreza e garuesit pa përmbajtjen sipas pikës 7.2 të këtijë neni është e pavlefshme.

4. Librezat e garuesve do të lëshohen dhe vërtetohen vetëm nga Zyra Administrative e FKK-së.

## II. REGJISTRIMI I KLUBIT

### Neni 8

1. Të gjitha klubet duhet të bëjnë regjistrimin vjetor në FKK.

2. Klubet duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim vjetor në Zyrën Administrative të FKK-së në periudhën 1 janar – 28 shkurt.

3. Klub i cili përmbushë kriteret për regjistrim sipas nenit 11 konsiderohet që ka përfunduar regjistrimin vjetor.

### Neni 9

#### REXHISTRIMI I PARË – KLUBET E REJA

1. Klubet që nuk kanë qenë anëtare të FKK-së asnjëherë dhe klubet pasive gjatë 24 mujave të fundit nëse plotësojnë kushtet për anëtarësim të përcaktuara me Statut të FKK-së (neni 3 i Statutit) duhet që Federatës t'i paraqesin kërkesën për regjistrim dhe anëtarësim duke bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:

- a) Kërkesën e klubit për anëtarësim
- b) Kopjen e Statutit të klubit
- c) Çertifikata e regjistrimit
- d) Kopjen e pagesës për regjistrim
- e) Kopjen e çertifikatës më së paku 1-DAN e lëshuar dhe/ose të nostrifikuar nga FKK-ja dhe të jetë jo më i ri se 21 vjeçar

2. Të gjitha dokumentet e cekura duhet dorëzuar në periudhën e përcaktuar sipas Nenit 8, pika 2 të kësaj Rregullorje.

## **Neni 10**

### **VAZHDIMI I REGJISTRIMIT**

1. Klubet të cilat kanë qenë anëtare të FKK-së vitin paraprak duhet që në periudhën e përcaktuar sipas Nenet 9, pika 2 të kësaj Rregullorje të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim:

- a) Kopjen e pagesës së kotizimit dhe regjistrimit të garuesve;
- b) Listën e të gjithë garuesve dhe anëtarëve të klubit (më së paku 5 anëtarë me të cilët duhet të merr pjesë në së paku tri gara zyrtare në vit).

## **Neni 11**

1. Klubet anëtare të FKK-së paguajnë anëtarësinë vjetore FKK-së për shumën, mënyrën dhe afatet e përcaktuara nga Bordi i FKK-së.
2. Pagesa e anëtarësisë duhet të bëhet përmes llogarisë bankare.

## **Neni 12**

1. Anëtarësia e një klubi në FKK pushon në rastet kur:

- a) Çregjistrohet me dëshirë,
- b) Përfundohet me vendim të kuvendit të FKK-së
- c) Vet shuhet,

## **Neni 13**

1. Në rast të ndryshimeve të kryesisë së klubit, trajnerët dhe garuesit, klubi duhet të njoftojë me shkrim Zyren Administrative të FKK-së për këto ndryshime menjëher pas ndryshimeve të bëra në klub.

## **III. REGJISTRIMI I GARUESVE**

### **Neni 14**

1. Kërkesën për regjistrim të parë të garuesit klubi mund ta parashtroj gjatë gjithë vitit, kurse vazhdimi i regjistrimit të garuesve nga viti i paraprak bëhet ekskluzivisht në periudhën e afatit kalimtar prej 1 janarit deri më 28 shkurt.

2. Regjistrimi i garuesit/ve të ri/një mund të bëhet në çdo kohë gjatë gjithë vitit kalendarik.

### **Neni 15**

1. Regjistrim i parë konsiderohet regjistrimi i garuesve të cilët për herë të parë regjistrohen ose garuesit të cilët nuk kanë qenë të regjistruar për asnjë klub së paku një vit.

2. Nxënësi anëtarësuar në klub, mund të regjistrohet si garues për herë prej moshës 7 vjeçare.

3. Kërkesën për regjistrim të PARË e parashtron klubi, kurse me kërkesë bashkangjet:

4. Në kërkesën për regjistrim duhet të deklarohet pranimi i statutit dhe Rregulloret e FKK-së nga garuesi
- Dëshminë e shtetësisë së Kosovës
  - (dy) fotografi të garuesit (foto 4 x 4 cm)
  - Librezën e regjistrimit në klub, të plotësuar dhe vërtetuar nga klubi.
  - Dëshminë e pagesës për regjistrim.

### **Neni 16**

1. Për të dhëna dhe dokumente të pasakta nga neni 15 i kësaj Rregullorje, klubi dhe garuesi mund të thirren në përgjegjësi disiplinore sipas dispozitave të rregullores disiplinore të FKK-së.

### **Neni 17**

1. Vazhdim i regjistrimit konsiderohet regjistrimi i garuesit i cili ka qenë i regjistruar edhe në vitin paraprak.

2. Nëqoftëse për garuesin nuk bëhet vazhdimi i regjistrimit as një vit pas kalimit të regjistrimit të fundit, pushojnë të gjitha obligimet dhe të drejtat në mes anëtarit dhe klubit. Anëtari në këtë rast është garues i lirë dhe mund të regjistrohet për cilindo klub dëshiron sipas dispozitave të kësaj Rregullorje, si regjistrim i parë (i ri).

3. Kërkesën për vazhdimin e regjistrimit të garuesit e parashtron klubi, dhe bashkangjet dëshminë për pagesën e paraparë për regjistrim.

### **Neni 18**

1. Me vendim të bordit të FKK-së caktohet shuma e taksës për regjistrim vjetor.

### **Neni 19**

1. Zyra e Administratës së FKK-së administron dhe mbanë evidencën e garuesve të regjistruar e cila përmbanë këto të dhëna për garuesin:

- Emri dhe mbiemri
- Numri unik personal
- Dita, muaji, viti, vendi dhe shteti i lindjes
- Profesioni
- Vendbanimi dhe adresa
- Klubi për të cilin garuesi është i regjistruar
- Klubi për të cilin garuesi më herët ka qenë i regjistruar dhe shënimet për pjesëmarrjen e fundit për klubin e mëhershëm
- Numrin e kartelës së regjistrimit

2. Përveç të dhënave të obligueshme nga paragrafi 1 i këtij neni, në evidencën e garuesve të regjistruar mund të regjistrohen edhe shënime të tjera për garuesin e regjistruar për nevoja të reprezentacionit shtetëror, siç janë shënime për gjatësinë turpore, pesha trupore e garuesit, numrin e veshëmbathjeve dhe shënime të ngjajshme.

#### **IV. TRANSFERIMET DHE KOMPENZIMET – DËMSPËRBLIMET**

##### **Neni 20**

1. Garuesi pa kontratë të përmbyllur realizon të drejtën e transferimit ashtu që nga klubi amë kërkon dokumentin e fletëçregjistrimit.
2. Garuesi me kontratë të skaduar ose që kontrata ka pushuar të vlejë me dëshirë të palëve kontraktuese, gjegjësisht nëse me vendim përfundimtar të autoritetit kompetent është konstatuar që për moskryerje të obligimeve të njerës palë kontraktuese kontrata ka skaduar, fletëçregjistrimi nuk është i nevojshëm për transfer në klubin tjetër.
3. Nuk është i nevojshëm fletëçregjistrimi për transfer në klubin tjetër për garuesin të cilit klubi nuk ia ka vazhduar regjistrimin për vitin vijues, pas afatit të përcaktuar për vazhdim.

##### **Neni 21**

I Dokument fletëçregjistrimi duhet të ketë këto të dhëna:

- a) Të dhënat presonale të garuesit,
- b) Klubi në të cilin garuesi ka qenë anëtarë
- c) Deklarata e klubit që garuesi është i lirë për regjistrin në klubit tjetër
- d) Nënshkrimi dhe vula e klubit nga i cili çregjistrohet garuesi

2. Klubi nuk mund të tërheq fletëçregjistrimin nëse njëherë ia ka lëshuar garuesit.
3. Klubi është i detyruar që në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së garuesit t'i japë fletëçregjistrimin ose të refuzoi kërkesën për dhënje të fletëçregjistrimit.
4. Në rast se klubi nuk përgjigjet në kërkesën për dhënje të fletëçregjistrimit në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, konsiderohet se nuk ka pengesa për transfer të garuesit nga klubi në klub.

##### **Neni 22**

1. Për transfer të garuesit nga klubi në klub, në parim nuk paguhet dëmshpërblimi, përveç nëse me kontratë në mes të klubit dhe garuesit ka pajtim ose nëse klubet bien dakord.

## V. TRANSFERI I GARUESVE – NDRYSHIMI I ANËTARËSISË

### A) Afati Kalimtar

#### Neni 23

1. Në përputhje me nenin 3 paragrafi 2 i kësaj Rregullorje që garuesi zgjedh klubin për të cilin dëshiron të marrë pjesë, përcaktohet afati kalimtar në të cilin transferi në klubin tjetër mund të realizoi secili garues pa kontratë, si dhe garuesi me kontratë, kontrata e të cilit me klubin ka pushuar të vlejë për arsyet e mëposhtme:

- a) *Me skadimin e kontratës,*
- b) *Kontratë e përfunduar me marrëveshje*
- c) *Fletlëshim të rregullt*

2. FKK njeh kontratat e lidhura në mes të garuesve dhe klubeve. Për konteste tjera që ndërlidhen me kontratat e tyre, ato zgjidhen në mes të palëve kontraktuese.

3. Garuesi pa kontratë realizon kalimin në afatin kalimtar në bazë të fletëçregjistrimit të klubit në pajtim me nenin 27 të kësaj Rregullorje.

#### Neni 24

- 1. *Afati kalimtar për të gjitha moshat është 2 (dy) herë në një vit kalendarik.*
- 2. *Afati i parë kalimtar (dimëror) është 1-31 janar, kurse afati i dytë kalimtar (veror) 1-15 shtator*
- 3. *Garuesit mund të shfrytëzojnë të dy afatet kalimtare (dimëror dhe veror) për ndrrimin e një apo dy klubeve brenda një viti kalendarik.*

#### Neni 25

1. Kalimi nga klubi në klub është i mundur gjatë afateve kalimtare nëse klubi nga i cili garuesi transferohet i jepë fletëçregjistrimin e rregullt, vie deri te ndërpreja e kontratës në dëm të klubit, me vendim të Bordit të FKK-së do të përcaktohet statusi i garuesit.

2. Transferi i arritur në mënyrën e rregulluar me paragrafin 1 të këtij neni, fiton të drejtën e përfaqësimit të klubit të ri menjëher pas aprovimit të kërkesës.

3. Garuesi i cili ka mosmarrëveshje në lidhje me kontratën me klub nuk mund të zhvillojë asnjë aktivitet si garues i FKK-së deri në zgjidhje të mosmarrëveshjes me klub.

### B) Procesi i transferit të garuesve nga klubi në klub



## Neni 26

1. Kërkesën për transfer të garuesit i cili TRANSFEROHET nga klubi në klub e parashtron klubi, e me kërkesë bashkangjet:

- a) Në formë të shkruar lutjen e garuesit në të cilën deklaron që pranon statutin dhe aktet e përgjithshme të klubit për të cilin regjistrohet, gjegjësisht Statutin dhe aktet e përgjithshme të FKK-së;
- b) Kontratën e nënshkruar në mes të garuesit dhe klubit, përveç kur kontrata nuk është e nevojshme ose nuk ka kontratë në mes garuesit dhe klubit;
- c) Fletëçregjistrimin e klubit (amë) të mëhershëm për garuesin pa kontratë. Për garuesit të cilët kanë pasur kontratë duhet dëshmia që në mes të klubit dhe garuesit është shkëputur kontrata;
- d) Dëshmia e pagesës së dëmshpërblimit për garuesin për të cilin është e nevojshme një pagesë e tillë.
- e) Dëshminë e pagesës për regjistrim;

2. Fletëlëshimi i lëshuar njëherë nga klubi nuk mund të tërhiqet.

3 Edhe pse një garues mund të ketë fletëlëshim të rregullt (për garues pa kontratë) nga klubi, ai/ajo mund të regjistrohet në klubin tjetër vetëm gjatë afatit kalimtar. Përveç rasteve që kanë të bëjnë sipas nenit 25, pika 3.

28.4 Garuesi i cili nënshkruan më shumë fletëregjistrime për më shumë klube, do të vlejë fletëregjistrimi i nënshkruar për klubin e parë, kurse në afatin kalimtar garuesi duhet të deklarohet për cilin klub regjistrohet.

## Neni 27

1. Garuesi pa kontratë i cili shprehë dëshirën që të lëshoi klubin e vetë amë duhet që nga i njëjti me shkrim të kërkoj fletëçregjistrimin.

2. Garuesi pa kontratë, fletëçregjistrimin mund ta kërkoj vetëm deri 15 ditë para fillimit të afatit kalimtar dimëror dhe/ose veror të përcaktuar me nenin 25 të kësaj Rregulloreje.

3. Klubi duhet që në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të kërkesës t'i japë fletëçregjistrimin ose të japë me shkrim shkaqet për ekzistimin e barrierave për dhënje të fletëçregjistrimit.

4. Fletëçregjistrimi ose refuzimi për garuesin duhet të jetë i vulosur dhe nënshkruar nga personi zyrtar i klubit.

## Neni 28

1. FKK nuk mund ta pranoj transferin e garuesit:

- a) Nëse ka Kontratë në të cilën ekzistojnë aso kushte të cilat garuesin e obligojnë dhe atë nuk e lejojnë, derisa të përmbushen kushtet e marrëveshjes;
- b) Nëse garuesi ka obligime financiare ose materiale ndaj klubit
- c) Dhe për rastet që kanë të bëjnë me nenin 25, pika 3.

### **Neni 29**

1. Nëse klubi pas afatit prej prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimin të kërkesës për dhënje të fletëçregjistrimit nuk përgjigjet me shkrim ndaj kërkesës së garuesit, do të konsiderohet që klubi është i pajtimit për dhënje të fletëçregjistrimit, dhe garuesi mund të regjistrohet për klubin e ri, pa kurrfarë dëmshpërblimi dhe fletëçregjistrimi (për garuesit pa kontratë).

### **C) Kundërshtimi dhe ankesa për mosdhënje të fletëçregjistrimit**

### **Neni 30**

1. Secili garues e ka të drejtën e ankesës ndaj klubit në rast të mos lëshimit të çregjistrimit.
2. Secili klub e ka të drejtën e ushtrimit të ankesës ndaj garuesit i cili lëshuar klubin pa marrëveshje me klubin.
3. Aneksat e parashtruara sipas këtijë neni, pikat 1 dhe 2 do të shqyrtohen nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së.
4. Ankesës së parashtruar Bordit Ekzekutiv të FKK-së duhet t'i bashkangjiten:
  - a) Kopja e kërkesës së garuesit për dhënje të fletëçregjistrimit;
  - b) Kopja e vendimit (njoftimit) të klubit për arsyet e mosdhënies së fletlëshimit;
  - c) Dëshminë e pagesës së taksës për ankesë.
  - d) Dokumente shtesë të palëve që konsiderojnë të jenë relevante për çështjen.
5. Secila palë që ushtron ankesë në lidhje me nenin 30 duhet të bëjë pagesën e taksës veç e veç. Lartësia e taksës përcaktohet me vendim të Bordit Ekzekutiv.

### **Neni 31**

1. Bordi Ekzekutiv duhet të merr një vendim për aneksat e parashtruara nga palët më së voni 30 ditë nga pranimi i ankesave.
2. Vendimi i marr nga Bordi Ekzekutiv për palët ankuuese duhet t'u dërgohet në formë të shkruar palëve.

## **VI. ANKESA PËR REGJISTRIM TË GARUESIT**

### **Neni 32**

1. Administrata e FKK-së është e obliguar që të njoftojë menjëher garuesin dhe klubin për arsye të mos regjistrimit.
2. Administrata e FKK-së obligohet që të njoftojë menjëher Bordin Ekzekutiv për arsyet e mos regjistrimit të palëve.

### **Neni 33**

1. Kur në bazë të ankesës konstatohet regjistrim i parregullt, kundër garuesit, klubit apo zyrtarëve të tjerë, atëherë Bordi Ekzekutiv do të zhvillojë procedurë disiplinore sipas rregulloreve ndaj administratës së FKK-së.
2. Nëse në bazë të ankesës konstatohet se nuk është kryer regjistrimi i rregullt sipas procedurave për regjistrim me këtë rregullore, ndërsa i njëjti është dashtë të bëhet, atëherë Bordi Ekzekutiv do të zhvillojë procedurë disiplinore sipas rregulloreve ndaj administratës së FKK-së.

## **VII. REGJISTRIMI I DYFISHTË I GARUESIT**

### **Neni 34**

1. Për ngritje të atraktivitetit në garat ekipore është e mundur për garime ekipore të regjistrohen garuesit nga klubet tjera në të ashtuquajturin regjistrim i dyfishtë.
2. Numri i garuesve përkohësisht të regjistruar duhet të jetë gjithmonë më i vogël se numri i garuesve vetanak dhe përcaktohet në këtë mënyrë:
  - a) Ekipet me 5 GARUES – janë të lejuar 2 garues me regjistrim të dyfishtë
  - b) Ekipet me 3 GARUES – është i lejuar 1 garues me regjistrim të dyfishtë.

### **Neni 35**

1. Klubi mund të regjistroj garuesin për gara ekipore me regjistrim të dyfishtë vetëm gjatë afatit kalimtar.
2. Me kontratën për regjistrim të dyfishtë të garuesve të cilat klubet i përfundojnë, rregullohen marrëdhënjet e ndërsjella të klubeve dhe garuesve.
3. Garuesi dyfish i regjistruar ka të drejtë të pjesëmarrjes ekipore vetëm për klubin për të cilin është regjistruar në mënyrë të rregullt dhe në afatin e paraparë.

### **Neni 36**

1. Regjistrimin e dyfishtë të garuesit e regjistron Administrata e FKK-së në bazë të lejimit të klubit amë dhe deklaratës së nënshkruar, dhe me këtë rast në librezën e regjistrimit vërtetohet regjistrimi i dyfishtë i garuesit për klubin për të cilin garuesi regjistrohet vetëm për takime ekipore.
2. Me kërkesë për regjistrim të garuesit, dorëzohet edhe deklarata me shkrim nga e cila vërtetohet se garuesi është i pajtimit të garoj për klub në garat ekipore.
3. Regjistrimi i dyfishtë duhet të përtërihet çdo vit kalendarik dhe garuesit me regjistrim të dyfishtë i jepet e drejta e regjistrimit për atë sezonë.
4. Garuesi me regjistrim të dyfishtë i regjistruar mundet të ndërroj klubin për të cilin do të marrë pjesë vetëm në gara ekipore në të dyja aftet kalimtare. Për transfer të garuesit me regjistrim të dyfishtë nuk është e nevojshme leja e klubit për të cilin ka marrë pjesë në garat ekipore.

## **VIII. KONTRATAT E KLUBEVE DHE GARUESVE**

### **Neni 37**

1. Marrëdhënjet e ndërsjella në mes të garuesve dhe klubeve rregullohen në përputhje me këtë rregullore dhe sipas marrëveshjeve të palëve.

### **Neni 38**

1. FKK do të njeh vetëm kontratat në mes të klubeve dhe garuesve me afat valid të vërtetuar nga një palë e tretë, zyre avokatie apo noteri.

## **IX. PJESËMARRJA E SHTETASVE KOSOVAR NË KLUBE TË HUAJA, SHTETASËVE TË HUAJVE DHE SHTETASVE KOSOVAR NGA DIASPORA NË KLUBET KOSOVARE**

### **Neni 39**

1. Bordi Ekzekutiv i FKK-së jepë lejen për pjesëmarrje në klubin/shtetin e huaj në bazë të kërkesës së garuesit, vetëm për garuesit anëtarë të përfaqësueses së Kosovës, ndërsa për garuesit që nuk janë anëtarë të përfaqësueses së Kosovës, lejen për pjesëmarrje në klubin/shtetin e huaj e lëshon administrata e FKK-së.
2. Garuesi i regjistruar për një klub të huaj nuk humb të drejtën e pjesëmarrjes në garat zyrtare të FKK-së.

#### **Neni 40**

1. Shtetasi i huaj ka të drejtë garimi për klubet Kosovare, në garat zyrtare të FKK-së. Shtetasi i huaj me leje qëndrimi në Kosovë mund të jetë anëtarë i përfaqësueses së Kosovës.

#### **Neni 41**

1. Shtetasit Kosovar nga diaspora kanë të drejtë regjistrimi për secilin klub të Kosovës dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha garat dhe kanë të gjitha të drejtat për sport si qytetarët e tjerë të Kosovës.

2. Shtetasit e Kosovës me nënshtetësi të dyfishtë kanë të drejtë regjistrimi për klubet kosovare dhe të drejtë pjesëmarrje në të gjitha garat zyrtare të FKK-së.

### **X. REGJISTRIMI I TRAJNERËVE, REFERËVE DHE ANËTARËVE TË TJERË TË FKK-së**

#### **Neni 42**

1. Një person mund të bëhet anëtar i FKK-së si trajner, në kushtet dhe mënyrën e përshkruar në Ligjin për Sport, Rregulloren për Trajnerë të Klubeve të FKK-së dhe rregullave të tjera të FKK-së.

2. Trajnerët trajtohen sipas rregullores për trajner. Ata/ato mund të regjistrohen si anëtarë të klubit. Për ta nuk vlejnjë dispozitat për afatet kalimtare.

3. Regjistrin e trajnerëve e administron Komisioni për Trajnerë të Klubeve të FKK-së ose personi i autorizuar nga komisioni për trajner.

#### **Neni 43**

1. Një person mund të bëhet anëtar i FKK-së gjyqëtarë i karatesë, në kushtet dhe mënyrën e përshkruar në Rregulloren e Komisionit të Gjyqëtarëve dhe rregullave tjera të FKK-së.

2. Referët regjistrohen sipas Rregullores së Gjyqëtarëve.

3. Regjistrin e gjyqëtarëve e administron Komisioni i Gjyqëtarëve të FKK-së në mënyrën e përshkruar në Rregulloren e Komisionit të Gjyqëtarëve të FKK-së.

## **Neni 44**

1. Klubet janë të obliguara që të plotësojnë formularin e FKK-së për strukturën udhëheqëse të klubit dhe të njëjtën ta paraqesin në administratë të FKK-së. Plotësimi dhe dorëzimi i formularit duhet të dorëzohet deri më 28 shkurt të çdo viti.

## **XI. REGJISTRAT DHE UDHËHEQJA E REGJISTRAVE**

### **Neni 45**

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullorje, komisionet përkatëse të FKK-së udhëheqin regjistrat e mëposhtëm:

- a) Regjistrin e klubeve të karatesë;
- b) Regjistrin e garuesve;
- c) Regjistrin e trajnerëve;
- d) Regjistrin e gjyqëtarëve;
- e) Regjistrin e gradave DAN

### **Neni 46**

1. Regjistri i klubeve të karatesë administrohet nga administrata e FKK-së
2. Në regjistrin e klubit, detyrimisht evidentohen këto të dhëna:

- a) numri rendor i regjistrit;
- b) numri amë i klubit;
- c) emri i klubit;
- d) vendi dhe adresa e klubit;
- e) data e themelimit të klubit;
- f) lista e dokumenteve të bashkangjitura me kërkesë (statuti, vendimi për regjistrim nga organi shtetëror, vendimi i DKRS i komunës)

### **Neni 47**

1. Regjistrin e garuesve e bënë administrata e FKK-së. Në regjistrin e garuesve detyrimisht evidentohen këto të dhëna:

- a) numri rendor i regjistrit;
- b) data e regjistrimit;
- c) emi, emri i babait dhe mbiemri;
- d) numri amë i garuesit;
- e) emri dhe vendi i klubit për të cilin regjistrohet;
- f) data e çregjistrimit nga regjistri.

## **XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 48**

1. Klubet paguajnë anëtarësinë vjetore FKK-së. Kotizimin vjetor dhe anëtarësinë për regjistrim të garueseve e cakton me vendim Bordi Ekzekutiv i FKK-së.

### **Neni 49**

1. Interpretimin e kësaj rregulloreje e bënë Komisioni për Çështje Ligjore dhe vendimet përfundimtare i merr Bordi Ekzekutiv i FKK-së.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullorje kryhen në mënyrë dhe procedurë të njëjtë të përshkruar për miratimin e saj.

### **Neni 50**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të Bordit Ekzekutiv dhe nënshkrimit nga Kryetari i FKK-së. Rregullorja do të jetë e disponueshme në web faqen e FKK-së.

Prishtinë 19 Qershor 2021

Ismet Krasniqi

  
Kryetar